



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2021:019027

Datë: 02.03.2021

Numri i dokumentit: 01557232

**P.nr. 101/21**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal**, Gjyqtari i vetëm gjykues Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Mihrije Krasniqi–Sheholli, në çështjen penale kundër të pandehurit A. G., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor, parashikuar nga neni 185 par. 3 nën par. 3.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.374/21, të dt. 22.02.2021, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik, të mbajtur më dt. 01.03.2021, në të cilin ishin të pranishëm Prokurori i Shtetit Ali Ajdini, e dëmtuara E. G., i pandehuri dhe mbrojtësi i tij av. B. S., me datë 02.03.2021 mori dhe publikisht shpalli si dhe përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

#### **I pandehuri,**

**A. G.**, nga i ati R. dhe nëna M., mbiemri i vajzërisë së nënës S., i lindur më data e lindjes..., në fshatin S. i P., Komuna P. ku edhe tani jeton, me numër personal të identifikimit numri i letërnjoftimit..., ka të kryer shkollën e mesme, me profesion ngjites i pllakave në K. i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike-financiare, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qëndruar në paraburgim nga dt. 01.02.2021, deri me dt. 01.03.2021.

### Ë S H T Ë F A J T O R

#### **Sepse:**

Me datë ..., rreth orës 16:00, në fshatin S. të P., konkretisht në shtëpinë e tyre, për shkak të mosmarrëveshjeve të vazhdueshme me të dëmtuarën bashkëshorten e tij E. G., shkak i dyshimit të të njëjtës, se bashkëshorti i saj tani i pandehuri po e tradhton me një grua tjetër, i njëjti ka ushtruar dhunë fizike dhe psiqike në vazhdimësi ndaj të dëmtuarës E., me qëllim të cenimit të dinjitetit të saj, në atë mënyrë kur e dëmtuara me datë ..., në telefonin e të pandehurit ka gjetur disa fotografi të një femre, e njëjta dyshon se i njëjti është në lidhje dashurie me atë, ashtu që ditën kritike kanë pasur një fjalosje lidhur me këtë, i njëjti i nervozuar pastaj e ka sulmuar fizikisht të dëmtuarën duke e goditur me një mjet të fortë të rrezikshëm-shpuzore, në këmbë dhe si pasojë e këtyre veprimeve, të dëmtuarës i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore me pasojë të përkohshme për shëndetin, në formë të ndrydhjeve në indet e buta dhe gërvishje e të ndejurave majtas.

- Me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor, parashikuar nga neni 185 par. 3 nën-par. 3.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave ligjore të neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69, 70 dhe nenit 185 par. 3 nën par. 3.1 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 248, 365, 366, 369, 370 dhe 453 të KPRK-së, të pandehurin e:

## G J Y K O N

**I. ME DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muaj**, të cilin dënim i pandehuri do ta vuaj në afatin prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

**II.** Konform nenit 79 të KPRK-së, në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 01.02.2021, deri me datë 01.03.2021.

**III.** Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 50.00pesëdhjetë€ (pesëdhjetë e/euro) euro, për ekspertizë mjeko ligjore shumën prej 20.00€ (njëzet e/euro), ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30€ (tridhjetë/euro), të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë.

**IV.** Pas shpalljes së aktgjykimit, konform nenit 44 të KPRK-së, me pëlqimin e personit të dënuar, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muaj, i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 200€ (dyqind/euro), të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguaj brenda afatit prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë, e në rast se nuk e paguan atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 (njëzet/euro) të pa paguara do t'i llogaritet 1 (një) ditë burgim..

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP.II.nr.374/2021, të dt. 22.02.2021, kundër të pandehurit A. G., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor, parashikuar nga neni 185 par. 3 nën-par. 3.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar më datë 01.03.2021, në të cilën prezantuan Prokurori i Shtetit Ali Ajdini nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, e dëmtuara E. G., i pandehuri dhe mbrojtësi i tij i caktuar sipas detyrës zyrtare av. B. S.

I pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, e ndjenë veten të fajshëm, është penduar dhe premtoi se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Prokurori i Shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ngase është bërë me vullnetin e tij, i propozon gjykatës që të aprovojë pranimin e fajësisë sepse është në përputhje me provat të cilat gjenden në shkresa të lëndës dhe konform dispozitave të nenit 248 të KPPRK-së.

Mbrojtësi i të pandehurit A. G. av. B. S., lidhur me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij deklaroi se: Pajtohet me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij, ngase pranimi i fajësisë është bërë pas konsultimit të mjaftueshëm lidhur me benefitet dhe pasojat e pranimit e fajësisë dhe konform dispozitave ligjore të nenit 248 të KPPRK-së, si dhe në përputhje me provat materiale të propozuara nga prokurori i shtetit, andaj nga gjykata kërkoi që pranimin e fajësisë ta pranoi dhe ta merr si rrethanë veçanërisht lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit, duke marr parasysh se i njëjti për herë të parë ka rënë në kundërshtim me ligjin, me të dëmtuarën-bashkëshortin e tij janë pajtuar, është baba i tre fëmijëve, mbajtës i vetëm i familjes po ashtu të merret parasysh deklarata e noterizuar e të dëmtuarës dhënë pranë zyrës noteriale në Podujevë, në të cilën e njëjta ka shprehur vullnetin e saj dhe ka deklaruar se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk ndjehet e frikësuar.

E dëmtuara E. G., lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri deklaroi se: Nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk parashtron kërkesë pasurore juridike, duke shpresuar se me të pandehurin-bashkëshortin e saj, do t'i rregullojnë raportet dhe nuk do të kenë probleme në të ardhmen.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, të dëmtuarës si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par. 1 të KPPRK-së, aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit në shqyrtimin fillestar, andaj konform nenit 248 par. 4 të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga vet i pandehuri, gjykata vlerëson se në veprimet inkriminuese të pandehurit përmbushën të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale Lëndim i lehtë trupor, të parashikuar nga neni 185 par. 3 nën-par. 3.1 të KPRK-së, për çka gjeti se në aspektin penal-juridik është përgjegjës dhe të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e mundshme lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i pandehuri në shqyrtimin fillestar ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, është penduar, ka kërkuar falje, me të dëmtuarën janë të martuar dhe janë prindër të tre fëmijëve, ndërsa si rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti, ashtu që ka ardhur në përfundim se dënimi me gjobë i shqiptuar të pandehurit është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë, me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë nga neni 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligji.

Vendimi për llogaritjen e paraburgimit në dënimin e shqiptuar është marrë konform nenit 79 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u marr në bazë të nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPRK-së dhe vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marrë, konform nenit 39 par.3 nën-par 3.1 të Ligjit nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit të dënimit me burgim në dënim me gjobë me pëlqimin e të dënuarit është marr në kuptim të nenit 44 të KPRK-së.

Vendimi mbi zëvendësimin e dënimit me gjobë në dënim me burgim është marrë në kuptim të nenit 43 par. 3 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal**  
**P.nr. 101/2021, me dt. 02.03.2021**

**Zyrtare ligjore**  
Mihrije Krasniqi - Sheholli

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
Gazmend Bahtiri

**Këshillë Juridike:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.